



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 40 Prot.

Rrogozhinë, më 01.08.2026

VENDIM

Nr. 31 , datë 01.08.2026

PËR KUNDËRSHTIMIN E DRAFTIT TË RI TË ORGANIZIMIT ADMINISTRATIVO-TERRITORIAL QË PARASHIKON SHKRIRJEN E BASHKISË RROGOZHINË

Këshilli Bashkiak Rrogozhinë, mbështetur në nenet 108 dhe 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, si dhe në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, Pasi u njoh me draftin e organizimit të ri administrativo - territorial të propozuar nga deputetët e mazhorancës në parlament, i cili parashikon shkrirjen e Bashkisë Rrogozhinë dhe bashkimin e saj me një njësi tjetër të vetëqeverisjes vendore; Duke vlerësuar se :

Vetëqeverisja vendore është një parim themelor kushtetues që garanton përfaqësimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe administrimin e interesave të komunitetit lokal. Bashkia Rrogozhinë përfaqëson një territor me identitet të konsoliduar historik, administrativ, ekonomik dhe shoqëror, i cili ka zhvilluar ndër vite institucionet dhe kapacitetet e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj. Shkrirja e Bashkisë Rrogozhinë do të sillte largimin e vendimmarrjes nga qytetarët, uljen e aksesit në shërbimet publike, dobësimin e përfaqësimit vendor dhe rrezikun e marginalizimit të interesave të komunitetit. Çdo reformë administrativo-territoriale duhet të mbështetet në analiza objektive, kritere të matshme, konsultim të gjerë publik dhe transparencë të plotë me komunitetet e prekura. Deri më sot nuk janë paraqitur argumente bindëse që provojnë se shkrirja e Bashkisë Rrogozhinë do të përmirësojë cilësinë e shërbimeve, eficiencën administrative apo zhvillimin ekonomik të territorit. Me propozim unanimit të anëtarëve të Këshillit Bashkiak nisur nga këto arsye dhe jo vetëm, me 18 (tetëmbëdhjetë) - vota pro, 0 (zero)-vota kundër, 0 (zero) - vota abstenim , Këshilli Bashkiak Rrogozhinë ,

V E N D O S I :

1. Këshilli Bashkiak Rrogozhinë shpreh kundërshtimin e plotë ndaj draftit të ri të organizimit administrativo-territorial, të propozuar nga deputetët e mazhorancës në parlament pjesë e komisionit të posaçëm parlamentar për reformën administrative - territoriale që parashikon shkrirjen e Bashkisë Rrogozhinë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

2. Këshilli Bashkiak kërkon ruajtjen e statusit të Bashkisë Rrogozhinë si njësi e pavarur e vetëqeverisjes vendore, duke vlerësuar se ajo plotëson funksionet, përgjegjësitë dhe misionin e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Këshilli Bashkiak i kërkon Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, Ministrisë përgjegjëse për pushtetin vendor dhe Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo - Territoriale që të rishikojnë draftin, duke marrë në konsideratë argumentet institucionale, ekonomike, sociale dhe historike të Bashkisë Rrogozhinë.
4. Këshilli Bashkiak kërkon që, përpara çdo vendimmarrjeje përfundimtare mbi organizimin administrativo - territorial, të zhvillohet një proces i plotë konsultimi publik me qytetarët, institucionet vendore, grupet e interesit dhe subjektet e tjera të prekura.
5. Ngarkohet Kryetari i Këshillit Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë për dërgimin e këtij vendimi pranë institucioneve qendrore përkatëse dhe për ndërmarrjen e çdo veprimi institucional në mbrojtje të integritetit administrativ të Bashkisë Rrogozhinë.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

**KRYETARË E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI**

